



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 74, datë 18.04.2025

PËR

KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË TITULLIN E OBJEKTIT TË VENDIMIT
NR. 14 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, DATË 04.10.2024 “PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT BANIMI DHE
SHËRBIMESH 5-20 KATE MBI TOKË ME 4 KATE PARKIM NËNTOKË”, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “LIMAN KABA”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të Nenit 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e gabimit material në titullin e objektit të Vendimit Nr.14 datë 04.10.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit: nga “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh 5-20 kate mbi tokë **me 4 kate parkim nëntokë**”, me vendndodhje në Rugën “Liman Kaba”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “TDT & Partners” sh.p.k”, në “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh 5-20 kate mbi tokë **me 5 kate parkim nëntokë**”, me vendndodhje në Rugën “Liman Kaba”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “TDT & Partners” sh.p.k”.
2. Të gjithë kushtet e tjera të Vendimit Nr.14, datë 04.10.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit mbeten të pandryshuara.
3. Ndryshimet e bëra në këtë vendim i shtrijnë efektet që nga data 04.10.2024.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 29/05 2025